

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

Prishtinë, 15.03.2022

Komiteti Olimpik i Kosovës ka statusin e personit juridik, është e regjistruar si organizatë joqeveritare pranë MAP si dhe i takon Lëvizjes Olimpikë duke u angazhuar që të respektojë dispozitat e Kartës Olimpikë, andaj si e tillë bashkëpunon me organet publike të Republikës së Kosovës për zhvillimin e sportit, lidh kontrata të ndryshme, punëson si dhe angazhon persona juridik dhe fizik të cilat janë të domosdoshëm për realizimin dhe arritjen e qëllimeve të promovimit të Lëvizjes Olimpikë, etikës në sport, qeverisjes së mirë si dhe zhvillimit të sportit në përgjithësi.

Në lidhje me njërën ndër misionet kyçe të KOK, e cila ndërlidhet ngushtë me bashkëpunimin e organeve publike në Republikën e Kosovës dhe ekspertëve ndërkombëtare për krijimin dhe përpilimin e Planeve Strategjike Kombëtare në fushën e Sportit me qëllim të dhënies së statusit “*sporti prioritet kombëtar*” në territorin e Kosovës, ne shpallim këtë:

Thirrje publike për aplikim të kompanive eksperte për përpilimin e Strategjisë Kombëtare në fushën e Sportit

Komiteti Olimpik i Kosovës bën thirrje publike për kompanitë vendore dhe ndërkombëtare eksperte në krijimin dhe përpilimin e Strategjisë Kombëtare në fushën e Sportit, e cila i plotëson kriteret e mëposhtme në mënyrë strikte.

Dokumenti “Strategjia e Sportit në Republikës e Kosovës 2023-2023” duhet të jetë e fokusuar në gjashtë fusha kryesore strategjike të sportit të cilat do të analizohen fillimisht nga ekspertët e fushës dhe e cila do të ndihmojë në realizimin e objektivave përkatëse. Këto fusha janë:

1. Infrastruktura sportive;
2. Financimi i Sportit;
3. Trajnerët e sportit (të edukuar);
4. Konkurrenca në sport;
5. Sporti shkollor dhe universitar;
6. Aktiviteti fizik dhe rëndësia e rekreacionit sportivë tek qytetarët e vendit tonë;

Kompania e cila do të kontraktohet për kryerjen e këtij shërbimi do të vlerësohet nga cilësia e saj dhe bazuar në numrin e planeve strategjike (në fushën) e sportit të suksesshme të cilat i ka realizuar. Bazuar në këtë, detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të kompanisë, janë si në vijim:

- a) Të përgatisë, mbikëqyrë dhe monitorojë procesin e mbledhjes së të dhënave (analizë) mbi sistemin sportivë në Kosovë – mbledhja e të dhënave është përgjegjësi e Kompanisë;
- b) Të krijojë një pyetësor për palët kryesore të interesit në sport (Komiteti Olimpik, federatat sportive, klubet e qyteteve të ndryshme, trajnerët, sportistët, qytetarët etj);
- c) Të konsultohet me KOK për formën e shpërndarjes së pyetësorit;
- d) Të analizohen të dhënat e pyetësorit si dhe të përgatiten konkluzionet;

KOSOVO



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

- e)* Krijimi i intervistave individuale në bashkëpunim me KOK;
- f)* Të dorëzohet raporti përfundimtarë i analizës së bërë për palët e interesit;
- g)* Të përgatitet drafti i analizës me shkrim;
- h)* Drafti i analizës me shkrim për gjendjen aktuale në sport të paraqitet pranë Ministrisë së Sportit dhe Komitetit Olimpik të Kosovës si dy akterët kyq në këtë fushë;
- i)* Komunikon me partnerët lokalë (Ministrinë e Sportit dhe Komitetin Olimpik të Kosovës) si dhe kërkon komente dhe sygjerime rreth analizës së bërë;
- j)* Përgatit draft-versionin e Strategjisë Kombëtare në fushën e Sportit në Kosovë për periudhën 2023-2030 në formë të shkruar;
- k)* Të paraqesë synimet dhe objektivat strategjike për sportin e Kosovës për vitin 2030 në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komitetin Olimpik të Kosovës;
- l)* Të përgatitet drafti dhe versionin final i Strategjisë për Sport në Republikës e Kosovës;
- m)* Të mbahet komunikim i rregulltë me KOK dhe të përgjigjet për çdo nevojë që mund të ketë KOK gjatë kornizës kohore të arsyeshme;

Për secilën detyrë dhe përgjegjësi të përshkruar më lartë mund të kërkohej raport nga KOK.

Kompania e cila do të aplikojë për këtë shpallje publike nga KOK, së bashku me ofertën e detajizuar duhet të bashkangjesë edhe dokumentet e tjera siç janë: certifikatat e biznesit, CV dhe ekspertëve të kompanisë të cilët do të merren me përpilimin e strategjisë së sportit në Kosovë, dëshmitë e sukseseve të tyre në të kaluarën si dhe planin e detajizuar të veprimit.

Kjo shpalljet do të jetë valide (e hapur) për 15 ditë rradhazi, respektivisht data e fundit e aplikimit është më 31 Mars 2022.

KOK do të shpallë njoftimin e kompanisë e cila është përzgjedhur për lidhjen e kontratës publike dy (2) ditë pas përfundimit të shpalljes.

Kompanitë kanë afat për ankesa (në rast të ndonjë pakënaqësie) 10 ditë nga dita e marrjes së njoftimit të përzgjedhjes së kompanisë nga KOK.